



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 19 – 7501 – 1-3-6/C222
14 Nr. 1179/19
Dt. 07.11.2019

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë Komunale për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Edi Kon “sh.p.k.** me seli në **Drenas**, me NRB : **810105644**, si Operatorë Ekonomik, të cilën e përfaqëson : **Skender Gjoshi**, në tekstin e mëtejshëm **SHITËSI - FURNITORI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike kornizë, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi dhe montimi i serave – faza e dytë , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	75	0	1	1	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	1	8	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi dhe montimi i serave – faza e dytë**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-118-136**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **15 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.**
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë si vijon : Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit – Pajisjeve, i emëruar enkas nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues, në momentin e dorëzimit të pajisjeve – makinave që janë lëndë e kësaj kontrate. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit – Pajisjeve të Autoritetit Kontraktues.
- 2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që secilën pajisje ta dërgoi – transportoi, me shpenzime dhe mjet transporti të tija, deri te vendbanimi i përfituesit, sipas regjistrimit të përfituesve të aprovuar nga Njësia Kërkuese – Shpenzuese. Një herit Furnizuesi merr për obligim që secilit fermer përfitues të pajisjes ti ofroi

shërbime të aftësisë dhe informimit të mjaftueshme lidhur me mënyrën e përdorimit dhe funksionimin e pajisjes së pranuar.

- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Garancioni për cilësinë e paisjeve do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të serave e pajisjeve përcjellëse dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **7.680,00€** (shtatmijgjashtëdhjet/00€).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht pas Pranimit të paisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara – Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.



dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Drejtoreshë Komonale për Prokurim Publik
Nënshkrimi:	
Data:	07.11.2019
Vula:	

Për Kontraktuesin - Furnizuesin:


Emri:	Skender Gjoshi
Pozita:	Përfaqësues i : Edi Kon "sh.p.k. - Drenas
Nënshkrimi:	
Data:	07.11.2019
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Numri i prokurimit:644-19-118-136 Titulli: Furnizimi dhe montimi i serave (faza e II-të)

Shënimi1: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonen E
Çmimin duhet ta shkruani vetëm me dy decimale pas presjes dhjetore.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia për 12 përfitues	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Vlera (me TVSH)-€
Serra të tipit tunel 50 m²					
1	Furnizim me skelet metalik të serrës dhe mbulimi me fole plastike tunel 50m ² komplet me montim	Copë	12	485	5,820.00 ✓
2	Sistemi i ujitjes pika pikë	Komplet /m/	960	0.6	576.00 ✓
3	Filtër ¾ me ventil mbyllës	Copë	12	6	72.00 ✓
4	Gyp ¾ plastike	m	72	1	72.00 ✓
5	Mbyllëse ¾ për gyp plastike	Copë	12	2	24.00 ✓
6	Ventil mbyllës plastike	Copë	96	1	96.00 ✓
7	Rezervuar i plastikës 1000l	Copë	12	70	840.00 ✓
8	Foleje e zezë	m ²	720	0.25	180.00 ✓
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:					7,680.00 ✓

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	EDI KON SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË	SKENDER GJOSHI
NËNSHKRIMI:	

At çmimi...



Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Arti kNr.	Përshkrimi	Njësia matëse	sasia
1	Serra të tipit tunel me sip. 50m ²	copë	12

Furnizimi dhe montimi i serrës me sipërfaqe 50 m²

Specifikacioni i serrës nga konstruksioni metalik i zinkuar me sipërfaqe 50 m²

.Serra të mbuluara me plastikë të formës "Tunel" me sipërfaqe 50m²

1. Specifikacioni i serrave për 50 m².

- Dimensionet: gjatësia 10m, gjerësia 5m, lartësia 2.8 m, gjerësia në mes mbajtësve 1.5 m deri 1.7 m.
- Themelet stop të metalta (180x150x3mm), me anker bazë (Ø 32 thellësi 500mm) dhe ankera përforcues (Ø25 mm 2 copë thellësi 500m)
- Konstruksioni i metalit (Ø 42 mm mbajtësit themelor, Ø 25 i gypave) të gjitha gypat të zinkuara me trashësi të mureve të gypave min 2mm.
- Përgjatë tërë gjatësisë së serrës për montim dhe demontim përdoren kapëset e plastikes.
- Sistemi i ventilimit përgjatë tërë gjatësisë së serrës në lartësi 55-150 cm në të dy krahët. (hapje e dritareve ne dy anët përgjatë tërë serrës)
- Dyert rrëshqitëse (1.5m x 2.2 m, 1 copë) në pjesën e përparme.

Numri i Prokurimit: 644-19-118-136– Titulli Furnizimi dhe montimi I serave (faza e II-të)

- Përgjatë tërë gjatësisë të jen të vendosur gypat metalik dhe sistemi i mbështetjes së bimëve (teli mbajtës për bimë)
- Folja plastike 180 mikronë, duhet të përmbajë këta aditiv: AF, AV, IR dhe UV me garancion 3-5 vjeçar.

2. Sistemi i ujitjes për një serre komplet

- 80 m aquacatel gyp pik-pikë çdo 10 cm pikëset me kapacitet 4/l, 1/h,/1 m gjatësi
- rezervuar i plastikës 1000l me lidhëse
- 8 ventil mbyllës të plastikës
- 1 filtër $\frac{3}{4}$ plastikës me ventil mbyllës
- 6 m gyp $\frac{3}{4}$ plastike
- 1 mbyllës $\frac{3}{4}$ plastike
- Rezervuar i plastikës 1000 l me pjesë lidhëse deri te gypi

3. Folije e zeze për një serre kompletet

- 60m² fole e zezë me trashësi 50mikron e cila duhet të mbulojë tërë sipërfaqen e serrës

Numri i Prokurimit: 644-19-118-136– Titulli Furnizimi dhe montimi I serave (faza e II-të)

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia për 12 përfitues
Serra të tipit tunel 50 m²			
1	Furnizim me skelet metalik të serrës dhe mbulimi me fole plastike tunel 50m ² komplet me montim	Copë	12
2	Sistemi i ujitjes pika pikë	Komplet /m/	960
3	Filtër ¾ me ventil mbyllës	Copë	12
4	Gyp ¾ plastikes	m	72
5	Mbyllëse ¾ për gyp plastike	Copë	12
6	Ventil mbyllës plastike	Copë	96
7	Rezervuar i plastikës 1000l	Copë	12
8	Foleje e zezë	m ²	720